

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
MARS - PRILL 2023**

Nr. rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e Përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	20.03.2023	<p>Për nevoja hetimi të procedimit penal Nr. 1347 i vitit 2022 , kërkojmë nga ana juaj informacion nëse përgjatë muajit Tetor të vitit 2021, është konstatuar ndonjë rast i prerjeve apo dëmtimeve të paligjshme të pyjeve, në zonën e Razmës, territor i Bashkisë Malësi e Madhe. Nëse po , të na vihet në dispozicion një kopje e njehsuar me origjinalin ,e procesverbalit të konstatimit të kundravajtjes.</p> <p>Për shkak të afateve të punës sonë, lutemi që përgjigjen të na e dërgoni sa më shpejt të jetë e mundur. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!</p>	30.03.2023	<p>Për sa kërkonti në shkresën tuaj Nr 2486 Prot. Datë 17.03.2023 e administruar nga ana jonë me shkresën Nr.822 Prot. date 20.03.2022 ju informojme si më poshtë :</p> <p>Gjate muajit Tetor 2021 nga ana e Inspektoreve te pyjeve nuk eshte konstatuar ndonje rast i prerjeve te pyjeve ne zonen e Razmes dhe nuk kemi procesverbal te konstatimit te kundervajtjes qe te jete mbajtur per prerje te pyjeve ne ate zone.</p> <p>Faleminderit per mirekuptimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka

2	20.03.2023	<p>Në vijim të shkresës tuaj me Nr.3197 Prot datë 12.12.2022 , nga ana e ekspertëve tuaj është kryer një akt ekspertimi për një sasi lënde drusore të ndodhur në ambientet e Repartit të FNSH-së Shkodër, kërkesë kjo në vijim të shkresës tonë me nr.10074 Prot datë 27.10.2022. nga ku rezulton se jeni shprehur vetëm pyetjeve në lidhje me llojin, moshën , kohën e prerjes dhe sasinë përkatëse të lëndës drusore.</p> <p>Sa më sipër kërkojmë të shpreheni në lidhje me faktin nëse mund të përcaktohet vendi i prerjes së asaj lënde drusore për të cilën keni kryer aktin e ekspertimit më datë 01.12.2022.</p> <p>Bashkëlidhur shkresës gjeni vendimin e ekspertimit me të dhënat përkatëse.</p> <p>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.</p>	30.03.202	<p>Për sa kërkonte në shkresën tuaj Nr.10074 Prot. Datë 17.03.2023 c administruar nga ana jonë me shkresën Nr.823 Prot. date 20.03.2023 , per plotesim te aktit te ekspertimit teknik-vleresues te dates 01.12.2022 te kryer nga ana e eksperteve të pyjeve ne bashkepunim me OPGJ prane Drejtorise tuaj dhe ku kerkohej te shprehet krahas tjerave edhe ne lidhje me faktin nese mund te percaktohet vendi i prerjes te asaj lende drusore, ju veme ne dijeni se percaktimi i vendit te prerjes te kesaj lende drusore eshte i pamundur duke ju referuar jo vetem vendit te ngjarjes por edhe se periudha ndermjet kryerjes se aktit te ekspertimit dhe kohes konstatimit per ngjarjen e ndodhur ne dt.04.10.2021 eshte relativisht e gjate.</p> <p>Faleminderit per mirekuptimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka
---	------------	---	-----------	---	------------	--------

3	30.03.2023	<p>Në lidhje me veprimet hetimore që po kryhen për procedimin penal nr.256 të vitit 2023 për veprën penale parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal kërkojmë të dhëna :</p> <ul style="list-style-type: none"> - A ka aplikuar shtetasi K.G për leje ndërtimi në fshatin Mokset,Njësia Administrative Kastrat - Nëse po, na dërgoni kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit të paraqitur. <p>Për efekt të zbatimit të afateve hetimore kërkojmë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e shkresës</p>	31.03.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.3067 datë 29.03.2023 dhe protokolluar me tonën me Nr.933 Prot, datë 30.03.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për të dhëna mbi shtetasin K.G banues në Mosket, njesia Administrative Kastrat, referuar procedimit penal Nr.256/2023, për vepren Penale të “Ndertim i Paligjshëm” dhe referuar procedimit penal nr.488 të vitit 2022 parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal.</p> <p>Ju informojme se, shtetasi K.G nuk është paraqitur pranë Bashkise tonë me kerkesë për leje ndertimi. Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka
4	30.03.2023	<p>Në lidhje me veprimet hetimore që po kryhen për procedimin penal nr.256 të vitit 2023 për veprën penale parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal kërkojmë të dhëna :</p> <ul style="list-style-type: none"> - A është mbajtur praktikë administrative për ndërtim pa leje në fshatin Mokset 	03.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.3067 datë 29.03.2023 dhe protokolluar me tonën me Nr.933/1 Prot, datë 30.03.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për të dhëna mbi shtetasin K.G banues në Mosket, njesia Administrative Kastrat, referuar procedimit penal Nr.256/2023, për vepren Penale të “Ndertim i Paligjshëm” dhe referuar</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Njësia Administrative Kastrat ndaj shtetasit K.G?</p> <p>- Nëse po, na dërgoni kopje të njehsuar me origjinalin të praktikës së mbajtur.</p> <p>Për efekt të zbatimit të afateve hetimore kërkojmë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e shkresës Duke ju falenderuar per bashkepunimin.</p>		<p>procedimit penal nr.488 të vitit 2022 parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal.</p> <p>Ju informojme se, nuk është mbajtur praktike administrative për ndertim pa leje në fshatin Mosket, Njesia Adminstrative Kastrat.</p> <p>Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>		
5	30.03.2023	<p>Në lidhje me veprimet hetimore që po kryhen për procedimin penal nr.259 të vitit 2023 për veprën penale parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal kërkojmë të dhëna :</p> <p>- A ka aplikuar shtetasi A.K për leje ndërtimi në fshatin Gjorm i Poshtëm, Njësia Administrative Gruemirë?</p> <p>- Nëse po, na dërgoni kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit të paraqitur.</p> <p>Për efekt të zbatimit të afateve hetimore kërkojmë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e shkresës Duke ju falenderuar për</p>	31.03.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.3066/2 datë 29.03.2023 dhc protokolluar me tonën me Nr.934 Prot, datë 30.03.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për të dhëna mbi shtetasin A.K banues në Gjorm i Poshtëm, njesia Administrative Gruemirë, referuar procedimit penal Nr.259/2023, për veprën Penale të “Ndertim i Paligjshëm” dhe referuar procedimit penal nr.488 të vitit 2022 parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal.</p> <p>Ju informojme se, shtetasi A.K nuk është paraqitur pranë Bashkise tonë me kerkesë për leje ndertimi.</p> <p>Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka

		bashkëpunimin.				
6.	30.03.2023	<p>Në lidhje me veprimet hetimore që po kryhen për procedimin penal nr.259 të vitit 2023 për veprën penale parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal kërkojmë të dhëna :</p> <p>- A është mbajtur praktikë administrative për ndertim pa leje në fshatin Gjorm i Poshtëm , Njësia Administrative Gruemirë ndaj shtetasit A.K ?</p> <p>- Nëse po, na dërgoni kopje të njehsuar me origjinalin të praktikës së mbajtur. Për efekt të zbatimit të afateve hetimore kërkojmë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e shkresës Duke ju falenderuar per bashkepunimin.</p>	03.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.3066 datë 29.03.2023 dhe protokolluar me tonën me Nr.934/1 Prot, datë 30.03.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për të dhëna mbi shtetasin A.K banues në Gjorm i Poshtëm, njësia Administrative Gruemire, referuar procedimit penal Nr.259/2023, për veprën Penale të “Ndertim i Paligjshëm” dhe referuar procedimit penal nr.488 të vitit 2022 parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal.</p> <p>Ju informojme se, nuk është mbajtur praktike administrative për ndertim pa leje në fshatin Gjorm i Poshtëm, njësia Administrative Gruemire. Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka
7	14.04.2023	<p>Kerkohet informacion ne lidhje me faktin nese nga ana e Bashkise Malesi e Madhe, eshte konstatuar nje ndertim i kryer pa leje (shtepi banimi), ne fshatin Gril, Njësia Administrative</p>	14.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me nr.3484 datë 11.04.2023 dhe protokolluar me tonën me Nr. 1052 Prot. date 14.04.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi ndertim pa leje (ndertim pa leje) nga ana e shtetasit N.L i datëlindjes</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Gruemire, Bashkia Malesi e Madhe, nga ana e shtetasit N.L i biri i M dhe i M , dtl.01.01.1964 , lindur ne Gimaj dhe banues ne fshatin Gril.</p> <p>Nese po, te na dergohct e gjithë praktika e mbajtur nga ana e juaj, mbi konstatimin e kundravjatjes penale, per te njejtin fakt penal, per te cilin nga ana e Komisarariatit te Policise Malesi e Madhe, eshte bere kallzim penal.</p>		<p>01.01.1958 banues në Grill, njs Adm Gruemirë, Bashkia Malesi e Madhe: N.L i datëlindjes 01.01.1958 banues në Grill, njs Adm Gruemirë, Bashkia Malesi e Madhe nuk ka asnjë kundravajtje penale nga ana e Inspektoriatit të Mbrotjes së Territorit.</p> <p>Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>		
8	14.04.2023	<p>Kerkohet informacion ne lidhje me faktin nese nga ana e Bashkise Malesi e Madhe, eshte dhene leje ndertimi me kerkese te bere nga shtetasi N.L i biri i M dhe i M , dtl.01.01.1964 , lindur ne Gimaj dhe banues ne fshatin Gril, per nje ndertim te kryer nga ana e tij (shtepi banimi), ne fshatin Gril, Njesia Administrative Gruemire, Bashkia Malesi e Madhe.</p> <p>Nese ky shtetas ka aplikuar, kerkohet e gjithë praktika e mbajtur nga ana e juaj, per</p>	19.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 3484 Prot, datë 11.04.2023, protokolluar me tonën me Nr. 1052/1 Prot, datë 14.04.2023, në lidhje me kërkesën për informacion për shtetasin N.L , i biri i M dhe i M, dtl.01.01.1964 lindur ne Gimaj dhe banues ne fshatin Gril, Njesia Administrative Gruemire, Bashkia Malesi e Madhe ju bëjmë me dije se personi në fjalë nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me leje Ndërtimi .</p> <p>Ju faleminderit!</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>paisjen me leje ndertimi ne baze te kerkeses se bere nga ky shtetas. Duke ju falenderuar per mirekuptimin .</p>			
9	18.04.2023	<p>Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është rregjistruar procedimi penal Nr.308/2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 199 i K.Penal. Për nevoja hetimore, kërkohet të na vini në dispozicion informacionin : 1-A ka lëshuar Institucionit Juaj Leje për kryerje punimesh ,si gërryerje toke etj në fshatin Razëm, Njësia Administrative Shkrel,Bashkia M.Madhe , shtetasit N.P (nqs po,bashkëngjitur informacionit leja e dhënë,të njëjtë me origjinalin). 2-A keni mbajtur praktikë administrative për shtetasin N.P për kryerje punimesh, si gërryerje toke etj,në fshatin Razëm,Njësia Administrative</p>	19.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 3631 Prot, datë 14.04.2023, protokolluar me tonën me Nr. 1065 Prot, datë 18.04.2023, në lidhje me kerkesën për informacion për shtetasin N.P , Razem, Njësia Administrative Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe, ju bëjmë me dije se personi në fjalë nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me leje Ndërtimi dhe as me Deklarate paraprake per kryerje punimesh. Ju faleminderit!</p>	Nuk ka

		Shkrel,Bashkia M.Madhe, (nqs po,bashkëngjitur informacionit praktika e mbajtur.) Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !				
10	18.04.2023	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar: Gj.K	24.04.2023	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.8372.Prot, datë 12.04.2023 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr. 1073 Prol, datë 18.04.2023, ju informojmë se subjekti Gj.K person fizik me numër Nipti:XXXXXXXXXX me administrator znj. Gj.K rregjistruar me datë 25/08/2015 në QKR. me aktivitet në fushën Bar-Kafë, me adresë Shkoder Kastrat Bajze, Lagjja Ivanaj, Rruga Shkoder Bajze, godina 1-kateshe, nr.65, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Ju faleminderit!	Përfunduar	Nuk ka
11	20.04.2023	Të nderuar, Pranë zyrës së avokatisë, është paraqitur shtetesja L.Q e bija e N dhe D e lindur me 20/01/1962, nr. personal XXXXXXXXXX ,e cila kërkon nxjerrjen e vjetërsisë në punë pranë Kooperativës	24.04.2023	Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në vijim të shkresës tuaj Nr. 20 Prot., datë 20.04.2023, të protokolluar me tonën me Nr. 1095 Prot, date 20.04.2023 ku kërkoni informacion i cili sipas regjistrave kadastral që posedon Bashkia Malësi e Madhe	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Bujqësore Bajzë. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj te informohemi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse është trajtuar nie ligjin 7501 datë 19.07.1991 “ Për tokën”, fshati Bajzë? - Nëse kryefamiljari N.Q ka qenë subjekt i ligjit 7501 apo ndonjë forme tjetër të trajtimit me tokë bujqësore? 		<p>nuk rezulton të jetë trajtuar me tokë familje me kryefamiljar N.Q sipas ligjit 7501 “Për Tokën” në Bajze. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		
12	20.04.2023	<p>Të nderuar, Pranë zyrës së avokatisë, është paraqitur shtetesja L.Q e bija e N dhe D e lindur me 20/01/1962, nr. personal XXXXXXXXXXXX , e cila kërkon nxjerrjen e vjetërsisë në punë pranë Kooperativës Bujqësore Bajzë. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj te informohemi;</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nëse dispononi dokumenta të vjetërsisë në punë pranë ish-KB Bajzë? -Nëse po, a ekziston emri i kërkueses në ato dokumenta? 	20.04.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr.1096 prot. më date, 20.04.2023, kërkesë për informacion, ju bëjmë me dije se: Nga kërkimet e bëra deri tani në Arkivin e Bashkisë Malësi e Madhe nuk rezulton dokumentacioni i kërkuar. Ju faleminderit për mirëkuptimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka
13	20.04.2023	<p>Në lidhje me detyrimet që Policia e Shtetit ka në</p>	24.04.2023	<p>Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 19.04.2023,të protokolluar në</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>procesin zgjedhor të datës 14 maj 2023 si dhe ne zbatim të nenit 79 të Kodit Zgjedhor dhe të Udhëzimit të KQZ-së, nr 6 datë 23 mars 2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" kërkojmë nga ana juaj të na njoftoni në lidhje me vendet e përcaktuara për vendosjen e materialve (posterave) gjatë kesaj periudhe në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		<p>institucionin tonë me Nr 91/36/Prot, bashkëlidhur po iu dërgojmë një kopje të vendimit të Kryetarit të Bashkisë z.Tonin Marinaj për përcaktimin e vendeve të afishimit. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		
14	28.04.2023	<p>Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ushtron aktivitetin e saj dhe përmbush detyrat funksionale, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga rezultatet e matjeve të pasakta.</p>	02.05.2023	<p>Ne përgjigje të shkrcës suaj nr.842.Prot, datë 25.04.2023, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr. 1143, datë 28.04.2023 "Mbi kërkesën për informacion", ju informojme se: Numri i licencave për transport udhëtarësh/taksi 4+1 në Bashkinë Malësi e Madhe është 1 (një), Subjekti P.Z me nr.NIPTI XXXXXXXXXXXX me adresë Koplik qendër. Licenca 8+1 nuk ka asnjë të lëshuar.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Një ndër detyrat e institucionit Tonë është edhe verifikimi i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, ndër të tjera edhe taksimetrat. Për këta instrumente matës, kërkojmë informacion në lidhje me numrin e subjekteve të cilat janë pajisur me licencë nga ana Juaj, për ushtrim aktiviteti në fushën: “transport udhëtarësh/taksi 4+1/8+1/ofrim i shërbimit taksi”.</p> <p>Me qëllim mbulimin e plotë të tregut në këtë fushë dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatorëve, kërkojmë bashkëpunimin tuaj me databazën për këto subjekte, me të dhëna, si: emër, NIPT, tip taksimetri.</p> <p>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.</p>		Faleminderit për bashkëpunimin!		
--	--	---	--	---------------------------------	--	--